

Rita Sahatçiu Ora

Biografia



Rita Ora lindi në Prishtinë, më 26 nëntor 1990. Po atë vit kur lindi, prindërit e saj u zhvendosën në Londër, ku u rrit. Ajo mësoi në “St Charles Catholic Sixth” dhe diplomoi në Shkollën e Teatrit për të Rinj. Rita filloi të këndonte në një moshë shumë të re. Në moshën 14-vjeçare, ajo filloi ta merrte muzikën shumë seriozisht. Paraqitja më e mirë e saj ishte si aktore në televizionin “UK”, me shfaqjen ”The Brief” dhe filmin “Spivs”. Në vitin 2009, Rita mori vëmendjen e Jay-Z, reper i njohur amerikan, me të cilin në heshtje e nënshkroi kontratën në “ROC NATION”, kompani kjo, me të cilën bëri edhe një reklamë.

Më 2007, Rita u shfaq në skenë me Craig Davidin, këngëtar i njohur në botë, me këngën "Vështirë", si dhe "Ku është dashuria juaj". Në vitin 2009, Rita ishte pjesë e videos së Jay-Z "Young Forever". Në vitin 2010, i përfitoi zemrat e publikut, kur sërish u shfaq si aktore në klipin e muzikantit Drake. Kjo ishte paraqitja e saj e katërt.

Rita punoi në albumin e saj debutues, i patitulluar. Punon me tekstshkrues dhe me producent të shquar, si: Drake (i cili ka punuar edhe me Alicia Keys, Jamie Foxx, Jeremih) , Makeba Riddick (ka punuar me Beyonce, Rihanna, Jennifer Lopez, Sugababes, Toni Braxton dhe Jessica Simpson), Martin Terefe (ka punuar me Train, Jason Mraz) dhe me “The-Dream” (ka punuar me Rihannan, Mariah Carey, Beyonce).

Debutimi i saj u konfirmua me emrin "Uneasy"(Jo e lehtë). Videoja për "Uneasy" u bë më 23 shtator 2010, me regji të Daniel Wolfe.

Më 14 dhjetor 2011, Rita Ora dhe DJ Fresh e realizuan video-spotin muzikor “Hot right now”, të cilin e nxorën në Youtube. Ndërkaq, kënga zyrtarisht u lansua më 12 shkurt 2012 dhe arriti në pozitën e parë të Top-listës britanike. Më 24 shkurt 2012, Rita, së bashku me Jay Z, e vizitoi

radiostacionin “Z 100” të Nju-Jorkut, ku ishte premiera e “singlit” të saj “How we do”.
Ndikimin më të madh muzikor e pati nga këngëtarja e famshme botërore Gwen Stefani dhe
Beyonce Knowels, të cilat Rita i adhuron shumë.